



Datë : 16.03.2020

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e shumta të parashtruara, nga Autoritetet Kontraktuese dhe duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 **për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik**, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerrë këtë :

NJOFTIM

Njoftim lidhur me situatën e krijuar si rezultat i corova virusit COVIT -19 , të gjitha Autoritetet Kontraktuese (AK) **që janë të prekura me** vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 **për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik**, mund t'i përdorin procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës që parashihen me nenin 35 të LPP-ës, konkretisht duke u bazuar në nenin 35 paragrafin 2.1 pikën (iii) e cila përcakton si në vijim:

2. *“Autoriteti kontraktues mund të përdor procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënie:*

2.1. çfarëdo kontrate publike:

(iii). *nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.*

Vërejtje: Në asnjë mënyrë nuk u lejohe Autoriteteve Kontraktuese që dispozitën në fjalë ta shfrytëzojnë për situata tjera që nuk kanë të bëjnë me vendimin e lartpërmendur.

Osman VISHAJ

Kryetarë i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

